



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr. 3513 Prot

Gjirokastrë, më 11 / 04 / 2023

VENDIM

NR. 30 Datë 11 / 04 / 2023

PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË GJIROKASTËR PËR AFISHIMIN PREJ PARTIVE POLITIKE DHE SUBJEKTEVE ZGJEDHORE TË MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE PËR ZGJEDHJET VENDORE, DATË 14 MAJ 2023.

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 79 "Afishimi i materialeve propagandistike" si dhe Udhëzimi Nr.6, datë 23 Mars 2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"

VENDOSA

1. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme në *Njësinë Administrative Gjirokastrë* për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

-Lagjja "Bulevardi 18 Shtatori", Rruga Nacionale Gjirokastrë- Kakavie

2. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme në *Njësinë Administrative Picar* për afishimin prej partive dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

- Qendra e fshatit Picar

Ura e Kardhiqit

4. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme në *Njësinë Administrative Lazarat* për afishimin prej partive dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

- *Qendra e fshatit Lazarat*

5. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme në *Njësinë Administrative Lunxhëri* për afishimin prej partive dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

- *Rruga Ura e Lumit-Çajup*

6. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme në *Njësinë Administrative Odrie* për afishimin prej partive dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

- *Qendra e fshatit Andon Poç*

7. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme në *Njësinë Administrative Antigone* për afishimin prej partive dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

- *Rruga Ura e Lumit-Parku Antigone*

Ky vendim bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë Gjirokastrër dhe një kopje e tij i dërgohet KQZ-së brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga miratimi i tij.

